

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shpenzime për mirëmbajtjeve mjeteve të transportit (Riparim mjeteve, ndërrim gomash, bateri dhe vaj)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09211100-2, 3435200-9, 42996700-1, Vajra motorrike, goma për automjete të renda/te lehta. Filtra, shërbime riparimi dhe mirëmbajtje makinash.

VLERA E FONDIT LIMIT: 6 666 650 (gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) **Lekë pa Tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tirane**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 të DST;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditees ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, ligji nr.10091 si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

3. Një dokument që vërteton se subjekti i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2022 referuar ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe sipas Vendimit të Keshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtarë duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 pika 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qënë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti Teknik

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 38% e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e kryera.
 - Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshminë përkatëse, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 38% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të cilit të ketë minimalisht 10 (dhjetë) punonjës sipas profileve të mëposhtme:
 - 2 (dy) motorrist
 - 1 (një) pompist
 - 3 (tre) xhenerikë
 - 1 (një) elektroaut
 - 1 (një) bojaxhi
 - 1 (nje) llamarinist
 - 1 (nje) ing. Mekanik profili transport (per automjete)

Për të vërtetuar se operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik të me profilet e punës të cituara më sipër, për secilin prej tyre duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës.
- Dëshmi lidhur me kualifikimit profesional
- Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtem:

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës
1			
2			

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do të paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Shënim 2.1:

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës të çdo punonjësi dhe ti ketë të deklaruar këta punonjës në profilet e kërkuara si më sipër në Listëpagesat e punonjësve (E-Sig 025) të deklaruara në organet tatimore, për periudhën Janar 2023-Mars 2023.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b)dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyres së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë riparime dhe mirmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocërisë, të sistemeve drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit etj është e nevojshme paisja e një stafi teknik me profesione si motorrist, pompist, xhenerikë, elektroaut, llamarinist, bojaxhi e vertetuar kjo në baze të kontratave të punës, dëshmitë të kualifikimit si dhe të deklaratës së plotësuar nga operatori ekonomik me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që kanë nevojë për kryerjen e shërbimeve, konkretisht në automjete, si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

3. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij, të paktën:

- 1 (një) Inxhinier mekanik/ teknik/ mekanik transporti, në detyrën/rolin e drejtuesit teknik.

Për punonjësin e drejtuesit teknik, OE duhet të paraqesi diplomën dhe Dëshminë e Aftësisë Profesionale të Përgjegjesit Teknik të veprimtarisë së autoriparimit (në zbatim të Ligjit Nr.9573, dt.03/07/2006) për nënkategorinë, si vijon:

- a- Riparim dhe mirëmbajtjen e pjesëve mekanike dhe të motorrit;
- b- Riparim dhe mirëmbajtje karrocërie;
- c- Riparim dhe mirëmbajtje impjanti elektrik;
- ç- Riparim dhe mirëmbajtje të gomave.

Drejtuesi teknik duhet të jetë me kohë të plotë pune pranë operatorit ekonomik. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratën individuale për 1 (një) Inxhinier mekanik/ teknik/ mekanik transporti

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të përcaktojë një person përgjegjës (drejtues teknik) për kryerjen e shërbimeve i cili kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e

nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafit teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me shërbimet që kërkojnë të realizohen të cilat janë elektrike, etj. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

4. Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambjent, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.

Për sa me sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë përkatëse sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronësi/qira/përdorim

Vendodhja që do të deklarohet detyrimisht do të paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Shënim

Nëse servisi, që disponon operatori ekonomik, ndodhet jashtë bashkisë, ku ndodhet autoriteti kontraktor, operatori ekonomik duhet të marrë përsipër, nëpërmjet një vetdeklarate, se do të kryerjë, me shpenzimet e veta, transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas, për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 6.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion ambjentin, mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, të cilat duhet të dërgohen në ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin të objektit të prokurimit.

5. Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës minimalisht, si vijon:

- a) 1 (një) copë pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergences) së rrotave të mjetit, të paktën 1 (një) copë;
- b) 1 (një) copë pajisje bango provë, për motorrinë dhe alternator (dinamo);
- c) 1 (një) copë pajisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete, 1 (një) copë;
- d) 1 (një) copë pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të frenimit të automjetit
- e) 1 (një) copë pajisje për kontrollin dhe testimin e sistemit të amortizimit të automjetit
- f) 1 (një) copë pajisje kontrolli sistemit të drejtimit (dhe të xhokove) / vetura & furgona
- g) 1 (një) copë pajisje të lëvizshme (portabile) për ndezje emergjente të mjetit 12v;
- h) 2 (dy) copë pajisje urë ngritëse për automjetet për mjete objekt prokurimi.
- i) 1 (një) grupe për kontrollin dhe riparimin e mjeteve të renda
- j) 1 (një) copë pajisje kontrollit sistemit të drejtimit (dhe të xhokove) për kamjona

- k) 1 (një) copë pajisje kontrolli në presion /difektimit cilindrave/ testatave të motorrit;
- l) 1 (një) pajisje për kontrollin & kalibrimin (riparimin) e turbokompresorit të motorrit
- m) 1 (një) copë paisje për kontrollin në presion të difektimit të sistemit të ftohjes;
- n) 1 (një) copë pajisje per pastrimin e motorrit nga brenda me H2
- o) 1 (një) copë pajisje per pastrimi e filtrit partikular DPF
- p) 1 (një) copë paisje për zëvendësimin e vajit të motorrit;
- q) 1 (një)copë paisje për zmontim & montim te gomave në diskun e gomës të mjetit;
- r) 1 (një) copë paisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave në mjet.
- s) 1 (një) copë furre & ambjent per riparim llamarine, stukime, lyerje (bojatisje) pjesore & komplet per vetura & furgona & kamjona
- t) 1 (një) copë pajisje per kalibrimi (drejtimit) te shasisë se mjetit vetura & furgona

Pajisjet që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, ku një pjese e tyre mund te ofrohet nga OE duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht ambientin e shërbimit – riparimit, makineritë, pajisjet bashkekohore, asetet e nevojshme të përcaktuara më sipër si dhe kapacitetet njerëzore, stafin e nevojshëm dhe kualifikimet profesionale me qëllim realizimin te objektit te prokurimit. Ndërkohe jo vetëm kaq, por specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara ne zërat e riparimit te kërkuara ne Shtojcën 6 (Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit).

Përfundimisht, nisur nga faktorët e mësipërm si dhe nga eksperiencia e punës qe kemi ne fushën e autoriparimit, theksojmë që numri i kërkuar mesipër nga ana jone për pajisjet është minimal dhe kjo është bërë në përputhje me LPP-ën dhe VKM-ës, për të bërë të mundur kështu pjesëmarrjen e gjerë të OE në realizimin e kësaj procedure prokurimi.

6. Operatori ekonomik duhet të disponoje minimalisht 1 (një) karrotrec,për transportimin e automjeteve të difektuara, ose në funksion të plotësimit të kriterit të përcaktuar në Shënim 4.1 , të pikës 4, të Kapacitetit Teknik,

Për sa më sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë përkatëse sipas formatit te mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/përdorim

Mjeti i transportit që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet

teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve, ndër të cilat mund të ndodh që në raste të caktuara duhet të transportojnë një automjet të difektuar në ambientet e servisit që disponon OE, është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) automjet, konkretisht karrotrec me qëllim realizimin të objektit të prokurimit.

7. Operatori ekonomik në lidhje me Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit që do të përdoren gjatë realizimit të shërbimeve të percaktuara në shtojcën 6 Formulari i Shërbimeve dhe Grafiku i ekzekutimit, duhet të plotësojë tabelën e mëposhtme duke specifikuar vendin e origjinës si dhe certifikimet të leshuara nga një organ i akredituar.

Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit			Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tirane
Nr.	Emertimi i produktit	Vendi i origjinës	Certifikatë konformiteti ose cilësie CE/ ekuivalent
1.			
2.			

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit të certifikuara sipas standarteve kombëtare/ndërkombëtare për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

8. Operatori ekonomik duhet të provojë që pjesët e këmbimit, për të cilat do të kryhen shërbimet e kërkuara, janë të furnizuara nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Dokumenti duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, Website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor, në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Me anë të kriteri synohet që të percaktohet orgjinaliteti dhe eksperiencia që OE ka lidhur me garantimin sa i përket burimeve të furnizimit për të gjitha pjesët e këmbimit që kërkohen gjatë riaprimin të mjeteve

9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kodet origjinale për të gjitha të pjeseve të këmbimit të cilat do të përdoren gjatë shërbimit / riparimit të automjeteve si dhe skemat orgjinale të montimit të pjeseve të këmbimit për të gjitha zerrat e riparimit të kërkuara në Shtojcën 2 të DT.

Argumentimi: Me anë të kriteri synohet që të bëhet percaktimi i sakte i pjeseve të këmbimit, pra për të mos krijuar konfuzion gjatë zbatimit konkret të kontrates, objekt i këtij prokurimi, në procesin e montimit të pjeseve të këmbimit të cilat kërkohen të jenë konform specifikimeve teknike të percaktuara në Shtojcën 2 dhe Shtojcën 5 të DT, sa herë të lind nevoja për riparim të mjeteve.

10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë, që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Me anë të kriteri ISO 9001:2015 synohet që të sigurohet se OE ofertues është i një standardi ndërkombëtar që specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë (QMS) për të demonstruar aftësinë për të ofruar vazhdimisht produkte dhe shërbime të standardi ndërkombëtar.

Me anë të kriterit ISO 14001:2015 synohet që të sigurohet se OE ofertues ka një menaxhim të pranueshëm mjedisor në lidhje me aktivitetin që ushtron. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën 36 dhe 79 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

11. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **Licencën e kategorisë VII.3.B.1**, (e vlefshme)“Riparimi dhe mirembajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për pikat a, b, c, ç, në përputhje me legjislacionin, për lejet dhe licencat, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe në zbatim të **Udhëzimit të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016**, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

12. Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B (në pronësi ose me kontratë shërbimi), lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nën ligjore të për bashkëta”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përbushur kontratën, të cilat janë të nevojshme për realizimin e shërbimeve kundrejt autoritetit kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tirane.

Shënim: Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pare duhet të dorëzojë prane AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

-Në të gjitha rastet kur emri ose marka,njihet një vlefshmëria apo baraz vlefshmëria,ose ekuivalent.

Shënim: Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pare duhet të dorëzojë prane AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

-Në të gjitha rastet kur emri ose marka,njihet një vlefshmëria apo baraz vlefshmëria,ose ekuivalent.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna,jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit te fituesit përfundimtar.
